



AKT THEMELUES

SHOQERISE SE RUAJTJES DHE TE SIGURISE FIZIKE
"RO.GAT SECURITY" SHPK

Sot me daten 02/04/2001, ne Tirane, Shqiperi:

Une, **Begator MANE**, i biri i Leskos, lindur ne Fier me 6/06/1966, banues ne Tirane, Rr."Stavri Themeli", N.78/1, mbajtes i leter njoftimit NF 496446, mbeshtetur ne Ligjen Nr.7512 date 10.8.1991, ligjen 7638 date 19.11.1992, Ligjen N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike", si dhe ne Legjislacionin Shqiptar ne pergjithesi, me cilesine e Ortakut te vetem Themelues, kam vendosur per sa me poshte vijon:

Neni 1

Te themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, per te zhvilluar veprimtari ne perputhje me Ligjin N.8770 date 19/04/2001, qe ka te beje me:

- sigurimin e objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike qe ushtrojne veprimtari ne Republikën e Shqiperise.
- sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te personave fizike, shtetas shqiptare ose/dhe te huaj.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet: Shoqeria e Ruajtjes dhe e Sigurise Fizike "RO.GAT SECURITY" Shpk

Neni 3

Shoqeria do te kete seline ligjore ne Tirane ne adresen Rr."Donika Kastrioti", N.4 Ne baze te nenit 5, pika 2 e Ligjit N.8770 date 19/04/2001 "Per Sherbimin e Ruajtjes dhe te Sigurise Fizike", Shoqeria ka te drejte te ushtroje veprimtarine ne te gjithë teritorin e R.Shqiperise.

Neni 4

Objekti i shoqerise do te jete kryerja e sherbimeve te kategorive (a+b):

- Ruajtja dhe Sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike, qe ushtrojnë veprimtari ne Republikën e Shqiperise.
- Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj.

Shoqeria per te permbushur misionin e vet, ka te drejte te vendose mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje nderlidhjeje, si dhe te perdore teknika te tjera, duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Per ruajtjen a objekteve, shoqeria mund te perdore edhe qen sherbimi, duke marre masat perkatese per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle ky lloj sherbimi.

Neni 5

Kohezgjatja e Shoqerise eshte fiksuar deri me 31 Dhjetor 2011 dhe mund te zgjatet ose te priset me perpara me vendim te Ortakut i Vetem Themelues.

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqerise, eshte percaktuar ne 4.000.000 (kater milion) Leke.

Ky kapital eshte nenshkruar dhe shlyer si me poshte:

4.000.000 (kater milion) leke, ne emer te Begator MANE, baras me 100% te Kapitalit te Shoqerise.

Neni 7

Viti financiar do te mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik. Viti i pare financiar do te mbyllet me 31.12.2001. Ortaku i Vetem Themelues kujdeset qe brenda kufijve dhe ne zbatim te normave ligjore te hartoje inventarin dhe bilancin te perbere nga gjendja pasurore, llogaria ekonomike dhe nga llogarite plotesuese duke i shoqeruar ato me nje relacion mbi ecurinee administrimit te Shoqerise.

Mbi te ardhurat neto qe rezultojne nga bilanci i vitit financiar do te zbritet nje kuote jo me pak se 5% per t'u shenuar si rezerve ligjore.

Neni 8

Administrimi i Shoqerise, Drejtimi Teknik dhe perfaqesimi ligjor i saj i besohet Ortakut te Vetem Themelues Z.Begator MANE .

Qysh nga ky çast vendoset qe te gjitha derdhjet e kapitalit te kryhen ne monedhe te vendit ashtu dhe fitimet dhe financimet eventuale te ardhshme nga ortakut i vetem themelues ose nga te tretet si dhe te gjitha arketimet qe kane te bejne me shitjen e Shoqerise, duhet te derdhen ne nje llogari qe do te hapet prane nje Banke ne Tirane.

Neni 9

Ky Akt u hartua ne kater kopje identike e me te njeten vlere.

ORTAKU THEMELUES

Begator MANE

